Aftësitë për Punësim Rural (APR)

HELVETAS Swiss Intercooperation KOSOVO

Raporti vjetor - 2013

Prishtinë, Shkurt 2014

Përmbajtja

1. INFORMATA THEMELORE **4**

2. PASQYRË E PËRGJITHSHME **5**

4. RAPORTIMI I TË ARRITURAVE BAZUAR NË REZULTATET E PRITURA **6**

4.1 REZULTATI 1: GRUPET MËSIMORE ME SYNIM TË RINJTË E PAPUNË 6
4.2 REZULTATI 2: PROGRAME TRAJNIMI PËR SEKTORIN PRIVAT PËR PUNËTORËT E RINJ DHE AKTUALË 7
4.3 REZULTATI 3: FUQIZIMI I LIDHJEVE TË ZINGJIRIT FURNIZUES 7
4.4 REZULTATI 4: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË OFRUESVE VENDORË TË SHËRBIMEVE 8
4.5 TEMA TRANSVERSALE 9

5. MENAXHIMI I PROJEKTIT **10**

5.1 MENAXHIMI I PROJEKTIT SIGURON ZBATIMIN EFIKAS TË AKTIVITETEVE, PËRMIRËSON ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË STAFIT DHE KAPITALIZON REZULTATET 10
5.2 EFIKASITETI 10

6. MËSIMET E NXJERRA **10**

7. ÇFARË TJETËR DËSHIROJMË TË THEMI **11**

8. SHTOJCAT **11**

SHTOJCA 1: FLETA E MONITORIMIT TË APR 12
SHTOJCA 2: FAKTE & SHIFRA PËR REZULTATIN 1 15
SHTOJCA 3: DEFINIMI I 'PUNËSIMIT' (**AKTIVITET EKO**NOMIK) 17
SHTOJCA 4: STUDIME RASTESH 18

Lista e shkurtesave

CNFA	Rrjeti i Qytetarëve për Punë të Jashtme
EU	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni për Sundim të Ligjit Evropian në Kosovë
HACCP	Analiza e Rrezikshmërisë dhe Pikët kritike të kontrollimit
GM	Grupi Mësimor
MM	Memorandum Mirëkuptimi
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PPJD	Prodhime pyjore jo-drunore
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PUM	Ekspertët e lartë nga Holanda
APR	Aftësitë për Punësim Rural
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Emergjencë të Fëmijëve
TAP	Trajnim Arsimimi Profesional

Harta me Zonat në të cilat ka intervenuar projekti

1. Informata themelore

Vendi: Kosovë Domeni i Strategjisë së Bashkëpunimit: Aftësitë dhe Punësimi	Titulli i projektit Aftësitë për Punësim Rural - APR

Qëllimi	Zvogëlimi i varfërisë në Kosovën rurale nëpërmjet trajnimit dhe zhvillimit të aftësive, që do të rezultojë me rritjen e mundësive për punësim
Rezultatet (R) *(Objektivi i projektit, Qëllimi)*	R1: Grupet Mësimore me synim të rinjtë e papunë R 2: Programe trajnimi për Sektorin Privat për punëtorët e rinj dhe aktualë R 3: Fuqizimi i Lidhjeve të Zinxhirit Furnizues R 4: Zhvillimi i kapaciteteve të ofruesve vendorë të shërbimeve

Kohëzgjatja e fazës së projektit: 01.01.2013 – 31.12.2015	Periudha e raportimit: 01.01.2013 – 31.12.2013

Buxheti në fazë (CHF)	1,297,097	Buxheti në vitin 2013 (CHF) Në vitin 2013 janë shpenzuar (CHF)	427,629 XXXXX

Organizatat implementuese:			
Partnerët kryesorë vendorë	Komunat, Drejtorati i Rinisë, Kulturës dhe Sportit, Drejtorati i zhvillimit ekonomik, Qendrat/Zyret publike për punësim, Drejtorati i Bujqësisë, Qendrat rinore, Sektori privat, Ofruesit vendorë të aftësive/Personi burimor	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë	UNDP – Konservimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Përdorimit të Tokës – Projekti në Dragash

Koordinatori i Projektit	Z. Luan Hoti	Numri i stafit ne projekt	Jo-vendorë: 0 Vendorë: 4
Konsulent jo-vendor (numri i diteve): Konsulent vendor (numri i ditëve):	52.5 739		

2. Pasqyrë e përgjithshme

Projekti Aftësitë për Punësim Rural (APR) filloi fazën e zbatimit në janar të vitit 2013 me financim nga Fondacioni Medicor, Fondacioni Julius Baer dhe HELVETAS Swiss Intercooperation

Që në fillim, vetë projekti u ballafaqua me sfida të ndryshme. Për të parën herë në Kosovë u prezantua metodologjia e Grupit Mësimor (GM). Në katër komuna në të cilat u zbatua projekti, pranimi nga të rinjtë ishte në nivel të kënaqshëm/të lartë. Raportet me institucionet vendore u krijuan brenda një afati të shkurtër kohor dhe projekti u përkrah fuqishëm. Bashkëpunimi me komunat u formalizua nëpërmjet të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit. Për më tepër, akterët e sektorit privat treguan gatishmëri të madhe gjatë bashkëpunimit me qëllim të gjithëmbarshëm për të lehtësuar aktivitetet e përgjithshme të projektit.

Duke u referuar në Rezultatin 1, trajnimi ka shfrytëzuar hapësirat/objektet e ofruara nga komunat pa pagesë. Në rastin e Kamenicës, komuna poashtu ka mbështetur grante për fermerët për blerjen e koshereve të bletëve, që është e përshkruar te Rezultati 3. Sektori privat është poashtu duke i mbështetur aktivitetet e projektit, duke siguruar ekspertizë për grupet mësimore, lidhje për marketing dhe qasje në hapësira për programet e trajnimit.

Zhvillimet më te spikatura të arritjeve të projektit në vitin 2013 janë të shënuara në vijim:

- 16 Grupe Mësimore kanë përfunduar ciklin mësimor;
- 193 pjesëmarrës kanë përfunduar trajnimet;
- Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 47% kanë qenë femra (objektivi 50%) dhe 24% minoritete (objektivi 25%);
- 24% ka filluar te mirret me aktivitete që kanë të bëjnë me trajnimin që kanë marrë;
- 8 Memorandume Mirëkuptimi (MM) janë nënshkruar me partnerët e sektorit privat (objektivi 5); megjithatë vetëm me 5 prej tyre janë inicuar aktivitete trajnimi;
- Një numër i përgjithshëm i 114 të punësuarve janë trajnuar, përkundrejt cakut të përgjithshëm që ka qenë 300. Kjo shifër përfshin 48 punonjës nga 5 biznese të mëdha dhe 66 punonjës (dhe të vetë-punësuar) nga bizneset e vogla. 10% nga këta kanë qenë punonjës të rinj nëpër biznese;
- Trajnimi u është dhënë 4 ofruesve të shërbimeve për t'iu ndihmuar në zhvillimin e planeve të biznesit për bizneset e tyre, dhe në këto raste janë angazhuar 5 ofrues të trajnimeve për trajnim teknik;
- 505 prodhues nga 4 zingjirë vlerash janë trajnuar në prodhimin e përmiresuar dhe praktikat e menaxhimit, duke përfshirë Produktet Pyjore Jo-Drunore (PPJD), mjedrat, mjaltën dhe prodhimet e qumështit. Këta prodhues janë organizuar në 31 grupe;
- Janë krijuar lidhje të forta me blerësit në secilin nga këta zingjirë të vlerës, dhe në shumicën e rasteve këta blerës janë angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin dhe mbështetjen e programeve të trajnimit si dhe në formimin e grupeve të prodhuesve;
- Projekti promovon aktivitetet e veta nëpërmjet të faqes së vet në internet dhe faqes në *Facebook*, duke promovuar rregullisht ngjarjet dhe arritjet e projektit për të gjitha palët e interesuara;
- Është krijuar një bazë të dhënash për projektin në të cilën menaxhohen dhe monitorohen të gjitha aktivitetet dhe kontratat e projektit që kanë të bëjnë me personat burimorë dhe ofruesit e shërbimeve;
- 6 nga 15 personat burimorë pritet të fitojnë punë jashtë projektit;

- Në muajin dhjetor është mbajtur një ngjarje rrjetëzimi në mënyrë që të bëhen bashkë të gjithë ofruesit e shërbimeve, personat burimorë, facilitatorët si dhe stafi ynë për të diskutuar dhe për një ngjarje me karakter social.

4. Raportimi i të arriturave bazuar në Rezultatet e pritura

4.1 Rezultati 1: Grupet Mësimore me synim të rinjtë e papunë

Rezultati 1	*Projekti APR do të stimulojë & mbështesë grupet e të rinjëve të papunë për të zhvilluar aftësitë vendore të kërkuara: teknike, të ndërmarrësisë dhe jetësore; që do të rezultojë me përmirësimin e mundësive për punësim dhe të ardhura*

Gjithsej 16 Grupe Mësimore përfunduan ciklin mësimor në vitin 2013, me gjithsej 193 pjesëmarrës. Shtojca 2 ofron informata të detajuara lidhur me këto grupe dhe sektorët në të cilët janë angazhuar.

Nga pjesëmarresit, 47% janë femra (objektivi 50%) dhe 24% minoritete (objektivi 25%). APR kishte për qëllim të arrijë synimin që 60% të pjesëmarrësve të cilët përfundojnë trajnimin të jenë ose të punësuar ose të vetë-punësuar, dhe që në fund të vitit 2013, 24% prej tyre të kenë ndryshuar aktivitetet e tyre dhe të kenë kaluar në lëminë në të cilën ka qenë trajnimi. Disa grupe përfunduan trajnimin aty kah fundi i vitit, dhe disa janë të angazhuar në aktivitete sezonale të cilat do të fillojnë në pranverë të vitit 2014. Pritet rritja e përqindjes së atyre që do të fitojnë punësim, dhe përmirësimet në këtë objektiv do të përfshihen në raportin e gjysmëvjetorit të ardhshëm.

Një studim me karakter gjurmimi është implementuar për Rezultatin 1, në të cilin të gjithë pjesëmarrësit kanë plotësuar një pyetësor para – gjurmues si dhe pyetesorët më të avancuar. Rezultatet nga kjo anketë kanë formuar një bazë për monitorimin e tabelave të përfshira si Shtojca 1 dhe 2.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për fushëveprimin e vitit të ardhshëm (drejtimi)

Grupet Mësimore janë një metodologji e re implementimi në Kosovë, dhe ca ‘mësim’ nga projekti ka ndodhur që në vitin e parë. Kjo ka përfshirë përmirësimin e procesit të formimit të grupeve dhe përdorimin e mënyrave të shpejta për vlerësimin e tregut në mënyrë që të vlerësohen mundësitë për zbatueshmërinë e ideve. Poashtu, është zhvilluar një proces më i fuqishëm i mentorimit dhe përcjelljes së aktiviteteve. Një diagram i këtij procesi të grupit mësimor është përfshirë si Shtojca 7 e këtij raporti.

Në fillim të projektit, 11 facilitatorë janë përzgjedhur dhe trajnuar në të gjitha 4 komunat në mënyrë që të ndihmojnë me zhvillimin dhe menaxhimin e grupeve mësimore. Përvoja tashmë tregon se një numër i vogël i facilitatorëve, me kontratë shërbimi permanente dhe me pagesë mujore drejtëpërdrejtë nga projekti, do te jetë alternativë më e mirë. Nga fillimi i vitit 2014, 1 facilitator do të jetë i angazhuar në secilën komunë, me nga një ndihmës facilitator të punësuar në Dragash dhe në Kamenicë. Ky ndryshim do të përmirësojë koordinimin midis projektit dhe facilitatorëve, por nuk do të ndikojë në buxhetin e përgjithshëm të projektit.

Nga 4 komuna, 2 kanë shënuar zhvillim të shpejtë (Kamenica dhe Dragashi) ndërsa në dy të tjerat (Novobërdë dhe Shtrpce) shkon më ngadalë. Në rastin e Novobërdës, kjo ka ndodhur për shkak të numrit të vogël të popullsisë si dhe shpërndarjes së saj si dhe mundësive të kufizuara. Komuniteti i donatorëve në Shtrpce ka qenë aktiv duke siguruar mbështetje financiare për popullatën e vet. Janë të domosdoshme përpjekje më të mëdha për të bindur të rinjtë në qasjen e metodologjisë së mësimit në grup. Pos kësaj, në Shtrpce çështja ka patur të bëjë me facilitatoret e mësuar të cilët nuk kanë qenë shumë aktivë dhe të përkushtuar ndaj rolit të tyre për shkak të paknaqësise me pagesat për shërbimet e tyre.

Situata e përgjithshme ka ndikuar që projekti të rimendojë një ndryshim të qasjes për zbatimin e projektit. Punësimi i drejtëpërdrejtë i facilitatorit është posaçërisht i rëndësishëm për të përmirësuar zbatimin e projektit në këtë rajon.

Poashtu, është zbatuar një qasje më formale ndaj zhvillimit të programit mësimor për secilin grup mësimor. Kolegët nga HELVETAS Swiss Intercooperation kanë trajnuar stafin e projektit APR për procesin e zhvillimit të programit mësimor, dhe kah fundi i vitit 2013 janë zhvilluar shtatë programe trajnimi duke përdorur këtë qasje.

1. 4.2 Rezultati 2: Programe trajnimi për Sektorin Privat për punëtorët e rinj dhe aktualë

Rezultati 2	*APR do të bashkëpunojë me bizneset ekzistuese (duke përfshirë edhe të vetë-punësuarit) për të zhvilluar programet e trajnimit të synuara të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë produktivitetin, punësimin dhe kushtet e punësimit.*

Rezultati 2 ka shënuar arritje mesatare në vitin 2013. Janë nënshkruar 8 Memorandume të Mirëkuptimit me partnerët e sektorit privat (objektivi 5); megjithatë aktivitetet e trajnimit janë inicuar me vetëm 5 prej tyre. Gjithsej 114 punonjës janë trajnuar në aftësi të ndryshme trajnimi (psh trajnimi për përmirësimin e standardeve të përgjithshme të kualitetit (HACCP), trajnimi për përmirësimin e aftësive të kamerierëve, qëndrueshmërine e mbledhjeve përfundimtare të prodhimeve pyjore jo-drunore) përkundrejt objektivit të përgjithshëm që ka qenë 300. Kjo shifër përfshin 48 punonjës në 5 biznese të mëdha dhe 66 punonjës (dhe të vetëpunësuar) nga bizneset më të vogla. 10% e tyre ishin punonjës të rinj nëpër biznese. Kjo shifër është arritur me kompanitë Meka në Dragash, Malësia në Kamenicë dhe Natyra në Novobërdë.

Janë trajnuar 4 ofrues të shërbimeve në mënyrë që të ndihmojnë në zhvillimin e planeve të biznesit për bizneset, dhe janë angazhuar 5 ofrues të trajnimeve për trajnim teknik.

Shumica e trajnimeve u zhvilluan në pjesën e dytë të vitit, kështuqë ende nuk ka në dispozicion të dhëna lidhur me rritjen e të ardhurave apo punësimin për bizneset e trajnuara.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për fushëveprimin e vitit të ardhshëm

Duke u bazuar në mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të Rezultatit 2, është zhvilluar një strategji e rishikuar në mënyrë që të arrihen objektivat për vitin 2014. Aktivitetet që u përkasin Rezultateve 2 dhe 3 duhet të bëhen në sinergji dhe duke plotësuar njëra tjetrën në mënyrë që të inkurajohen më shumë biznese që të angazhohen në projekt. Që të arrihet kjo, i njëjti punonjës do të jetë përgjegjës për të dy rezultatet.

Poashtu ka pasur kërkesa nga bizneset për të dhënë trajnime të nivelit më të lartë nga ekspertët, nga ato që projekti APR mund të jipte, kështuqë do të gjinden ekspertë vullnetarë nga OJQ ndërkombëtare si Swisscontact, CNFA dhe PUM.

Për të pasur qasje në bizneset e vogla dhe për t'u ofruar trajnim specifik bazuar në nevojat e tyre, facilitatorët u angazhuan me kontrata vjetore për të ndihmuar në identifikimin e grupeve të synuara në secilin rajon. Një strategji për qasjen në inputet e furnizuesve të bizneseve të vogla është poashtu e përfshirë në planet e aktiviteteve të vitit 2014.

4.3 Rezultati 3: Fuqizimi i lidhjeve të Zingjirit Furnizues

Rezultati 3	*Integrimi i zinxhirit të furnizimit nëpërmjet të zhvillimit të aftësive të ndërmarrjeve të vogla në dy zonat e përqëndruara me kompanitë vendore dhe rajonale do të përmirësojë mundësitë e vetë-punësimit.*

Gjithsej 505 prodhues në 4 zingjirë vlerash janë trajnuar në përmirësimin e prodhimit dhe

praktikave të menaxhimit, duke përfshirë Prodhimet Pyjore Jo-Drunore (PPJD), mjedrat, mjaltën dhe prodhimet e qumështit. Këta prodhues janë organizuar në 31 grupe.

Janë krijuar lidhje të forta me blerësit në secilin nga këta zingjirë vlerash, dhe në shumicën e rasteve këta blerës janë angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin dhe mbështetjen e programeve të trajnimit dhe formimin e grupeve të prodhuesve. Në rastin e programit të prodhimeve të qumështit në Dragash, të gjithë: blerësi, qendra për grumbullimin e qumështit, personi burimor vendas dhe bujqit kanë qenë të angazhuar në identifikimin e nevojave për trajnim, dhe në zhvillimin e programit të trajnimit. Grumbullimi i qumështit dhe cilësia e përgjithshme e prodhimit është ngritur nga kjo kohë, dhe gjithnjë e më shumë bujq po inkurajohen t'i bashkangjiten programit.

Një shembull i mbështetjes është arritur në Kamenicë përmes të sigurimit të qasjes financiare. Një grup bletarësh me sukses i është qasur komunës së Kamenicës në mënyrë që të marrin bashkë-financim për blerjen e koshereve të reja të bletëve. Mbështetja e projektit APR ka qenë e rëndësishme në mënyrë që të përgatitet një analizë e qartë e shpenzimeve dhe fitimit për bashkë-financim, dhe trajnimi teknik i cili u është ofruar poashtu ka rritur mundësitë për sukses nga perspektiva e komunës. Një ndërhyrje tjetër në këtë rajon ka qenë të prodhohen të ashtëquajturat 'mbretëresha' për këto koshere në nivel lokal, në vend që të importohen ato nga Serbia.

Meqenëse këta zingjirë vlerash janë shumë sezonalë, nuk është e mundshme që të mbledhen të dhëna gjatë muajve të dimrit. Monitorimi do të bëhet gjatë pranverës dhe verës së vitit 2014 në mënyrë që të vlerësohen rezultatet dhe ndikimi i arritur, dhe këto informata do të përfshihen në raportet e mëvonshme.

Programet e trajnimit tani po zhvillohen në mënyrë më të sistemuar, duke përdorur një grup të vogël të ekspertëve i ndihmuar nga stafi i projektit. Janë përdorur pako të trajnimit në mënyrë që të inkurajohen investimet, me ç'rast projekti ka përdorur fonde të vogla për të blerë inpute, por vetëm në rastet kur bujqit dhe blerësit kanë mbështetur këto investime.

Implikimet e rezultateve dhe procesi për fushëveprimin e vitit të ardhshëm (drejtimi)

Planifikimi për vitin 2014 ka për qëllim të ndërtoje mëtutje rezultatet e arritura me zingjirët e vlerave. Gjithnjë e më tepër prodhues po i qasen projektit duke u bazuar në përhapjen joformale të informatës në mesin e komuniteteve lokale. Mundësitë e tilla do të perfshihen në Rezultatin 3 vetëm në rastet kur i plotësojnë kërkesat tona për ndërlidhje me blerësit ekzistues dhe kur kanë një mundësi të mirë në treg.

Në vitin 2014, projekt dokumenti parasheh përfshirjen e 2 zingjirë vlerash jo-bujqësore. Kjo do të kërkojë analizë të mëtutjeshme të mundësive, dhe projekti APR planifikon të angazhojë ofrues shërbimesh nga jashtë për të analizuar mundësitë në secilën komunë. Zingjirët e vlerës të tekstilit, artizanateve, teknologjisë informative dhe të shërbimeve janë identifikuar në këtë projekt dokument si sektorë të pershtatshëm, por kjo do të analizohet më tej në tremujorin e parë të vitit 2014.

4.4 Rezultati 4: Zhvillimi i kapaciteteve të ofruesve vendorë të shërbimeve

Rezultati 4	*Projekti APR do të mbështesë ofruesit vendorë të shërbimeve për të ofruar shërbime trajnimi dhe për aftësi të cilat janë më shumë të bazuara në aktivitetet e lidhura me trajnimin praktik dhe sektorin privat, dhe janë pjesë përbërëse e sistemit formal të ATP-së*

Projekti promovon aktivitetet e veta nëpërmjet të faqes së vet në internet dhe faqes në *Facebook*, duke promovuar rregullisht ngjarjet dhe arritjet e projektit për të gjitha palët e interesuara.

Uebfaqja dhe Linku ne *Facebook* janë:

http://www.helvetas-ks.org/s4re/

Është krijuar një bazë të dhënash për ofruesit e shërbimeve në të cilën menaxhohen dhe monitorohen të gjitha aktivitetet dhe kontratat e projektit që kanë të bëjnë me personat burimorë dhe ofruesit e shërbimeve. Gjurmimi i aktiviteteve dhe objektivave të projektit në këtë mënyrë është dëshmuar të jetë shumë i dobishëm. Detajet e kontaktimit dhe fusha e specializimit të personave burimorë si dhe ofruesve të shërbimeve te angazhuar nga projekti janë në dispozicion në faqen e internetit të projektit. Kjo i'u ka ndihmuar 6 nga 15 personat burimorë të fitojnë punë jashtë projektit. Projekti ka per qëllim angazhimin e ofruesve lokalë të shërbimeve, në mënyrë që të sigurohen shërbime të përballueshme në nivel lokal për qytetarët. Disa nga ofruesit e shërbimeve, akterët e sektorit privat, janë angazhuar për herë të parë si trajnerë. Përvoja me projektin APR i ka siguruar ata që të ofrojnë të njëjtat shërbime për të tjerët. Një rast si ky është me personin burimor për punë me stoli. Ajo ka qenë e angazhuar që të trajnojë një grup femrash të reja, përfituese të projektit APR. Menjëherë pas përfundimit të detyrës së saj me projektin APR, ajo u angazhua nga UNICEF-i.

Në muajin dhjetor është mbajtur një ngjarje rrjetëzimi në mënyrë që të bëhen bashkë të gjithë ofruesit e shërbimeve, personat burimorë, facilitatorët si dhe stafi ynë për të diskutuar si dhe për një ngjarje sociale. Dy ngjarje të tilla janë planifikuar për vitin 2014, dhe ato do të mbahen në rajonet përkatëse ku po zhvillohen aktivitetet e projektit.

4.5 Tema transversale

■***Gjinia:*** Gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit, projekti APR kërkon të inkurajojë pjesëmarrjen e barabartë të femrave në të gjitha aktivitetet e projektit. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se gati 50% të përfituesve të projektit në grupet mësimore janë femra. Ekzistojnë disa kufizime që e parandalojnë përfshirjen e barazisë gjinore dhe avancimin e pozicionit të gruas dhe ato janë rolet dhe perceptimet tradicionale të grave. Në zonat rurale në të cilat projekti ushtron aktivitetin, femrat janë të gatshme të marrin pjesë në trajnime për të fituar aftësi për punësim. Megjithatë, ideja e grave për të hyrë në biznes nuk përkrahet aq shumë financiarisht nga prindërit, e kjo sidomos në mënyrë specifike ndodh për femrat e reja të cilat pritet të martohen në të ardhmen e afërt. Kështu, edhe pse të inkurajuara, përfitueset grupe mësimore të gjinisë femërore përfitojnë më pak prej fondit të mundësive që i'u ofrohen. Projekti APR do të përpiqet që nga ai të përfitojnë në mënyrë të barabartë edhe femrat edhe meshkujt. Të dhënat e zbërthyera në aspektin gjinor mund të shihen në fletën e monitorimit. (shih shtojcën 1)

Për më tepër, projekti ka përdorur një qasje jo diskriminuese në përzgjedhjen e facilitatorëve të rinj/të mësuar dhe ofruesve lokalë të shërbimeve, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë.

■***Qeverisja me një fokus në gjithëpërfshirjen sociale:***

Aktivitetet e projektit APR promovojnë përfshirjen sociale të minoriteteve. 25% të përfituesve të projektit janë minoritete. Nga gjithsej 193 të rinj të trajnuar nëpërmjet grupeve mësimore, 46 përfitues janë minoritete etnike. Përveç kësaj, një grup mësimor i përbërë nga minoritetet është mbështetur për të startuar me biznes të ri nëpërmjet fondit te mundësive.

Më tej, projekti ka promovuar aktivitete ndëretnike. Një grup mësimor në Kamenicë, për pastiçeri/gatim, i përbërë prej tri grupeve të ndryshme etnike me sukses ka përfunduar trajnimin. Pjesëmarrësit kanë ndërvepruar në baza ditore me njëri-tjetrin, duke pasur kështu mundësinë të integrohen në aspektin social. Edhepse gjuha vazhdon të mbetet barrierë.

5. Menaxhimi i projektit

5.1 Menaxhimi i projektit siguron zbatimin efikas të aktiviteteve, përmirëson zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe kapitalizimin e rezultateve

Gjatë vitit 2013, stafi i projektit nuk ka pasur udhëtime studimore apo trajnime jashtë vendit. Megjithatë, janë siguruar trajnime nga ekspertët që kanë ardhur këtu për vizita pune për trajnimet për Grupet Mësimore (shkurt dhe prill), Vlerësimi i shpejtë i tregut (nëntor) dhe Përfshirja gjinore (dhjetor).

Projekti ka marrë mbështetje nga këshilltarë të ndryshëm ndërkombëtarë. Janë organizuar gjithsej 9 misione të tilla gjatë këtij viti.

5.2 Efikasiteti

Projekti APR ka arritur rezultate shumë të mira në arritjen e objektivave te tij. Shumica e aktiviteteve të projektit janë zbatuar sipas buxhetit të planifikuar. Duke u referuar në Rezultatin 1, numri i synuar i të rinjëve që kanë ndjekur trajnimin, është arritur me më pak fonde sesa ka qenë buxhetuar. Megjithatë, në mënyrë që të angazhohen me shumë të rinj në aktivitetet fitimprurëse, objektivi për punësimin, fondet e buxhetuara kanë qenë modeste dhe janë vlerësuar si minimale për vitin e ardhshëm.

Buxheti i përgjithshëm i shpenzuar këtë vit ka qene 89%.

6. Mësimet e nxjerra

- Planifikimi i mirë: Në menyrë që të sigurohet zbatim i duhur dhe në mënyrë të rregullt i aktiviteteve të projektit, projekti APR bëri një plan të detajuar të veprimit në fillim te vitit. Plani është shqyrtuar periodikisht dhe është azhurnuar sipas nevojës.
- Stafi i kualifikuar: Projekti APR ka futur metodologji të re në Kosovë. Metodologjia e Grupeve Mësimore ka qenë e re edhe për stafin vendor. Prandaj, konsulenca ndërkombëtare për të transferuar njohuritë ka qenë kritike në mënyrë që të sigurojë se stafi vendor është kompetent dhe i pajisur mjaftueshëm në mënyrë që të prezantojnë metodologjinë në terren.
- Trajnimet e nxitura nga kërkesa: Projekti ka ofruar trajnim për aftësi bazuar në nevojat e të rinjëve. Të rinjtë kanë vlerësuar nevojat e tyre duke i përshtatur ato me kërkesën në treg. Për të siguruar programe të realizueshme për zhvillimin e aftësive, projekti APR do të prezantojë trajnimin Vlerësimi i shpejtë i tregut si një metodë thelbësore për vlerësimin e nevojës dhe të tregut. Projekti APR është i përkushtuar të ofrojë trajnim të bazuar në kërkesë.
- Bashkëpunimi me akterët vendorë: Projekti është dëshmuar të jetë më i suksesshëm në Kamenicë. Të rinjtë dhe sektori privat në këtë komunë ka qenë më aktiv. Kjo është arritur me disponueshmërinë e personave burimorë dhe gatishmërinë e tyre për të transferuar njohuritë e tyre tek të rinjtë.
- Koordinimi i donatorëve: Nevojitet koordinim i shtuar me komunitetin e donatorëve. Ana negative e komunitetit të donatorëve të cilët janë aktivë në komunat ku projekti zhvillon aktivitet është ofrimi i përfitimeve pa bashkë-financim. Për këtë shkak, projekti ka hasur shumë pak sinergji në aktivitetet e veta.
- Zhvillimi i ekipit: Projekti APR përbëhet nga një ekip prej katër personash. Fryma ekipore në mes të stafit ka qenë vendimtare për sukses. Secili dhe të gjithë e kanë parë njëri tjetrin si të ndërvarur, dhe kështu kanë plotësuar ekipin.

7. Çfarë tjetër dëshirojmë të themi

Projekti Aftësitë për Punësim Rural kryesisht synon të rinjtë e papunë të moshës prej 16-31 vjeç. Metodologjia e Grupit Mësimor (GM) është dëshmuar të jetë e suksesshme duke marrë parasysh pjesëmarrjen aktive të të rinjëve në programin e trajnimit. Qasja e GM mundëson mobilizim të komunitetit dhe përfshin më tepër akterë në trajtimin e çështjes së papunësisë sp: akterët privatë, autoritetet komunale etj. Përvoja me grupin mësimor tregon se fondet e vogla kanë sjellë ndryshimin. Projekti APR rekomandon rritjen e fondit të mundësive. Në vitin e dytë, numri i të rinjëve të trajnuar është trefishuar, përderisa fondi i mundësive ka mbetur i njëjtë siç ka qenë në vitin e parë. Një fond më i madh i mundësive do t'i kontribuonte një ndikimi më të madh të projektit.

8. Shtojcat

Shtojca 1: Fleta e Monitorimit të APR

Shtojca 2: Fakte & Shifra për Rezultatin 1

Shtojca 3: Definimi i aktivitetit ekonomik

Shtojca 4: Studime rastesh

Shtojca 1: Fleta e monitorimit të APR

HELVETAS Swiss Intercooperation Projekti Aftësitë për Punësim Rural (APR) – Fleta e monitorimit											
	Indikatori	2013			2014			2015			Në total 2013-2015
		Objektivi 2013	**Për gjys-mën e vitit**	**Vjetor**	**Objektivi 2014**	**Për gjys-men e vitit**	**Vjetor**	**Objektivi 2015**	**Për gjys-men e vitit**	**Vjetor**	**Në total**
1.1	# grupe mësimore te krijuara	10	19	16	30			40			
1.1	# facilitatorë të formuar	8	10	7	0			0			
1.2	# të rinj të papunë kanë përfunduar trajnimin	200	59	193	600			800			
1.2	% femra të reja dhe të papuna të trajnuara	50	56%	47%	50			50			
1.2	% minoritete - të rinj dhe të papunë të trajnuar	25	36%	24%	25			25			
1.3	% të të rinjëve të papunë kalojnë në vetë-punësim apo punësim	60	7%	24%	60			60			
1.3	# MM e nënshkruar me një partner IMF	1	0	0	1			1			
2.1	# MM të nënshkruara	5	6	8	8			7			

	me bizneset e sektorit privat										
2.2	# punonjës të bizneseve të mëdha (të rinj dhe aktualë) të trajnuar	100	0	48	150			150			
2.2	# punonjës të NVM (të rinj dhe aktualë) të tra-jnuar	200	0	66	200			200			
2.2	% të punonjësve të rinj të trajnuar	25%	-	10%	25%			25%			
2.3	# kontrata të nënshkru-ara me ofruesit e trajni-meve për punonjës	5	0	5	0			0			
2.3	# kontrata të nënshkru-ara me ofruesit e trajni-meve për planifikim të biznesit	5	1	4	0			0			
3.1	# VC të identifikuar dhe MM e nënshkruar	6	4	4	0			0			
3.1	# përfitues të trajnuar - PPJD Mbledhja e egër	200	122	100	400			500			
3.1	# përfitues të trajnuar - PPJD të kultivuara	50	0	10	100			100			
	# përfitues të trajnuar -										

	Manaferra & Fruta										
3.1	# përfitues të trajnuar - PPJD të kultivuara	100	105	108	100			100			
3.1	# përfitues të trajnuar - Prodhimet e qumështit & Blegtori	100	142	180	200			200			
3.1	# përfitues të trajnuar- Mjaltë	50	95	107	100			100			
3.1	# përfitues të trajnuar – Tekstil & Punëdore	0	0	0	50			50			
3.1	# përfitues të trajnuar - Shërbime (TI/Financa)	0	0	0	50			50			
3.2	# grupe të ofertuesve me aftësi të përmirësuara	30	29	31	60			60			
4.1	# ofrues të trajnimeve të fuqizuar	4	2	15	3			3			
4.1	% ofrues të trajnimeve të angazhuar në projekte tjera përpos në APR	50%	20%	40%	50%			50%			

Shtojca 2: Fakte & Shifra për Rezultatin 1

Monitorimi i informatave për Rezultatin 1 Azhurnuar në janar 2014															
Komuna	Profesioni	**Grupet Mësi-more**		**Cikli i Trajnimit të Grupit**		**Planet e Biznesit të Grupeve**		**Përkatësia etnike (Grupet)**			**Gjinia (Grupet)**		**Punësimi (Individët)**		
		Pjesëm arrësit	**Në vazhdim e sipër**	**I për-fun-duar**	**Në vazhdim e sipër**	**I për-fun-duar**	**Shqip.**	**Pjesëm arrësit**	**Në vazhdim e sipër**	**I për-fun-duar**	**Në vazhdim e sipër**	**I për-fun-duar**	**Shqip.**	**Pjesëm arrësit**	**Në vazhdim e sipër**
Kamenicë	Pastiçeri/Gatim	2	28		28	1		8	18	2	1	27	4		
	Prodhimi i luleve	2	22		22	1	2	13	9		8	14			3
	Stolitë	1	13		13	1		13				13			7
	Bletari	1	11		11		1	11			9	2			6
	Rritja e pulave	1	10		10	1	1	10			10				5
	Kamerierë	1	12		12			12			12		3		
Novobërdë	Teknologji infor-mative	1	15		15	1	1	15			15				8
Shtrpce	Prodhimi i luleve	1	6		6	1	1		6		4	2			3
	Dekorimi i ëmbël-sirave (I anuluar)	1	7		0										
Dragash	Mjedrat	1	16		16	1	1	16			16				7
	Rregullimi i flokëve	3	32		32	3	1	21		11		32			0
	Ngrohje qendrore	1	16		16	1		16			16				0

	Instalimi elektrik	1	12		12	1		12			12				1
Ne total			200		193			147	33	13	102	91	7	0	40

Shtojca 3: Definimi i 'Punësimit' (Aktivitetit ekonomik)

Përkufizimet formale të punësimit të përdorura nga grupet si International Labor Organization (ILO)/ Organizata Ndërkombëtare e Punës, nuk mund të përdoren në kontekstin e projektit APR, duke qenë se kanë kanë prirje të jenë masa me karakter krahasues (psh ndryshimet prej një muaji në tjetrin) më tepër sesa vëzhgimi i vlerave absolute. Përveç kësaj, këto masa formale nuk përfshijnë në mënyrë adekuate ndërmarrësit e vegjël apo të dhënat joformale për vetë-punësimin.

Për këtë arsye, projekti APR propozon përdorimin e termit 'aktivitet ekonomik' në vend të 'punësimit' për matjen e rezultateve.

Aktivitet ekonomik është çdo aktivitet që siguron një kthim ekonomik për përfituesin. Ky mund të jetë punësim me pagë, vetë-punësim, prodhim, ofrim shërbimesh apo aktivitet tregtie.

Rezultati 1 ka një objektiv për të arritur 60% punësim për anëtarët e grupit mësimor. Prandaj, ne definojmë këtë si 60% të anëtarëve të grupit të cilët ndërmarrin aktivitet ekonomik që është në përputhje me trajnimin e marrë brenda periudhës 3 mujore pas përfundimit të trajnimit. Kjo do të matet përmes pyetësorëve më të avancuar të plotësuar nga të gjithë anëtarët e Grupeve Mësimore.

Për t'ia atribuar një vlerë këtij aktiviteti ekonomik është poaq e vështirë të bëhet. Nëse përcaktojmë objektivin në një vlerë mujore, kjo nuk e njeh natyrën sezonale shumë të lartë të disa aktiviteteve – ose kohën edhe më të gjatë të marrjes së fitimit.

Nëse është përcaktuar vlerë shumë e lartë e punësimit, nuk do të njohë faktin se edhe një rritje e vogël e fitimit mujor për të rinjtë e papunë është një përmirësim i dukshëm. Aq më natyrë joformale dhe aq më i vogël të jetë aktiviteti ekonomik poashtu do të paraqesë sfidë në sigurimin e informatave lidhur me të.

Prandaj, ne propozojmë që të përdorim kriteriumin 'kthim pas investimit' për të përshkruar rezultatet tona në nivel grupi.

Grupet Mësimore pranojnë 'investim' nga projekti për trajnim dhe inputet tjera, mesatarisht rreth 1,000 € për grup. Ne propozojmë që të masim aktivitetin e përgjithshëm ekonomik të anëtareve të grupeve krahasuar me investimin e drejtëpërdrejtë nga projekti si një indikator i punësueshmërise së shtuar te anëtarëve.

Është propozuar për të vendosur këtë në vlerën 150% - për një investim në vlerë 1,000 € ne do të prisnim të shohim një kthim prej 1,500 € në paga, shitje, tregti etj. nga anëtarët e grupit.

Kur përfituesit fitojnë punësim për një pagë, ne do të masim këtë vetëm nëse kjo pagë plotëson kushtin e pagës minimale për Kosovë (170 € për muaj me orar të plotë) dhe nëse barazohet më shumë se 50% me një pozitë me orar të plotë (20 orë në javë).

Shtojca 4: Studime rastesh

Studim Rasti: Grupi Mësimor në Kamenicë – Rritja e pulave –rruga mëtej

Pasqyrë e përgjithshme

Kamenica është një komunë multi-etnike në veri-lindje të Kosovës. Ka një popullsi prej 36,000 banorësh dhe prej tyre një numër të përafërt me 5,000 të rinj (meshkuj dhe femra) të papunë, është një rajon i rëndësishëm për projektin APR. Një seri takimesh janë organizuar në këtë rajon në muajin mars të cilat kanë rezultuar me një seminar ndërgjegjësimi me të rinjtë vendas. Një grup i përbërë prej katër meshkujsh vlerësoi mundësi të ndryshme dhe vendosi të fillojë me prodhimin e vezëve si një aktivitet të grupit të tyre.

Konkurrenca në prodhimin e vezëve në këtë rajon nuk është e fortë, dhe nuk ka asnjë fermë pulash afër Kamenicës. Vendimi i tyre ishte bazuar në këtë vlerësim të tregut vendor, si dhe në hapësirat e kufizuara të tokës për kultivim në të cilën kishin qasje, por në të njëjtën kohë edhe në nivelin e lartë të fuqisë punëtore brenda grupit të tyre. Një sistem intensiv siç është prodhimi i vezëve u përshtatej kërkesave të tyre.

Ndërhyrja nga projekti APR

Pas disa takimeve me të rinjtë, duke parë motivimin e tyre dhe besimin e fortë në idenë që kishin, projekti vendosi që në muajin prill të mbante trajnimin për grupin. Trajneri Ilir Zenelaj, një ekspert për shpezë qe nuk ishte nga rajoni i tyre, u ofroi të rinjëve mbështetje teknike dhe profesionale. Trajnimi teknik është përbërë nga shtatë seanca. Pas kësaj, grupi është trajnuar të përgatiste një plan të biznesit të cilin ata i'a dorëzuan projektit APR si kërkesë për mbështetje financiare. Investimi i përgjithshëm për këtë iniciativë ka qenë 17,980 € duke përfshirë këtu edhe tokën e vendndodhjes së prodhimit. Pas vlerësimit të planit të biznesit, projekti APR ka kontribuar me 5,400 € për blerjen e 960 shtresave (zogjve) dhe 600 kafazesh. Grupi vendosi të emëronte biznesin 'Veza e artë'.

Rezultatet e bashkëpunimit

Fillimisht 10 anëtarë të grupit do të ishin të angazhuar në projektin me 2000 zogj. Megjithatë kostoja ishte shumë e lartë për pjesëmarrësit, kështuqë vetëm 5 të rinj u angazhuan me një numër më të vogël zogjsh. Duke qenë se biznesi ka për qëllim të rrisë numrin e pulave që prodhojnë vezë, pritet që grupi i ndërmarrësve të rinj do të rritet me një ritëm prej 10% në vit, duke punësuar me shume anëtarë.

Nga 5 persona të angazhuar aktualisht, njëri e menaxhon biznesin, 2 janë përgjegjës për prodhimin dhe 2 për marketing dhe shitje. Kapaciteti i prodhimit është 850-900 për një ditë.

Aktualisht, në rajonin përreth, tregu ka pak konkurrencë, duke siguruar kështu kushte ideale për ndërtimin e biznesit. Pritet që qarkullimi vjetor për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit të jetë 8,080 €.

Studim Rasti: Zhvillimi i aftësive shton efektivitetin e biznesit

Pasqyrë e përgjithshme

Fillimi I funksionimit të përpunuesit të qumështit “Malësia” në Kamenicë në vitin 2013 është duke u përqëndruar në ofrimin e prodhimeve të shëndosha të qumështit si djathi dhe jogurti. Që të sigurohet se këto prodhime janë konkurruese në tregun vendor, kërkohet që punonjësit të jenë në gjendje të menaxhojnë procesin e prodhimit. Megjithatë, Malësia e kishte të vështirë të gjente punëtorët e duhur – ekspertë për këtë në rajonin e tyre, duke kufizuar kështu aftësinë e tyre për të shfrytëzuar mundësitë e tregut.

Ndërhyrja nga projekti APR

Pavarësisht faktit se Malësia kishte filluar me grumbullimin e qumështit të papërpunuar, asaj i mungonin punonjësit kyç të cilët do të menaxhonin në mënyrë efektive procesin e prodhimit. Projekti APR dhe Malësia vendosën të bashkojnë përpjekjet e tyre për të punësuar dy teknologë me aftësitë e duhura dhe një teknik laboratori. Projekti APR mundësoi procesin e përzgjedhjes, si dhe intervistoi aplikuesit. Të intervistuarit morën pjesë në një trajnim proaktiv dhjetëditor të mbajtur nga profesionisti i mirënjohur vendas dhe teknologu me përvojë Z. Begzad Maliqi. Pesë ditët e para të trajnimit ishin disenjuar që të mësojnë të trajnuarit me gjithë procesin e prodhimit, dhe në pesë ditët tjera secilit i’u dha përgjegjësia për të menaxhuar proceset kyçe si pranimi i lëndës së parë, fermentimi, paketimi dhe ruajtja.

Rezultatet e bashkëpunimit

Një investim mesatar në vlerë të 700 € është ndarë barabartë në mes të projektit APR dhe Malësisë. Kjo ka rezultuar me punësimin e dy teknologëve dhe të një tekniku të laboratorit. Tre të trajnuar u familjarizuan me procesin e prodhimit si dhe me sfidat në të cilat mund të hasin në të ardhmen si dhe me mënyrat se si do të mund t’i trajtojnë ato. Me mbështetjen e projektit APR, Malësia arriti të zhvillojë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme të punonjësve të saj kyç. Si rezultat i kësaj, Malësia ka filluar me prodhimin e prodhimeve të qumështit si djathi, jogurti dhe specat në kremë qumështore. Këto prodhime tani janë në dispozicion në supermarkete dhe dyqane të vogla në Kamenicë dhe Gjilan.

Studim Rasti: Bujqit e Dragashit përqafojnë kultivimin e mjedrës

Pasqyrë e përgjithshme

Dragashi është një komunë multi-etnike që ndodhet në Kosovën jugore dhe ka një popullsi prej 33,584 banorësh. Me pak mundësi ekonomike apo qendra urbane, papunësia është e lartë, duke rezultuar kështu me migrim të konsiderueshëm nga rajoni. Megjithatë, është vend i pasur me burime natyrore, zona malore, pyje të mëdha dhe tokë bujqësore pjellore. Bujqit e rajonit të Dragashit janë të mirënjohur për prodhimin e prodhimeve të qumështit, duke përfshirë këtu shumë lloje të djathrave të shijshëm. Grumbullimi i mjedrave dhe prodhimeve tjera pyjore jo-drunore është poashtu i njohur, dhe Dragashi është shtëpia e kompanisë Hit Flores, një përpunues i madh i këtyre prodhimeve.

Ndërhyrja nga projekti APR

Si përgjigje mundësive të pashfrytëzuara të tregut për mjedra, me 1 tetor, projekti APR baskoi forcat me kompaninë Hit Flores për të rritur kultivimin e mjedrës në rajon. Projekti APR mbajti dy seminare dhe përzgjodhi 20 bujq për t'i mbështetur. Bujqit janë përzgjedhur duke u bazuar në kriteriume si mosha, gatishmëria për të kontribuar në ndarjen e shpenzimeve dhe të lokacionit. Këtyre bujqve i'u është ofruar edhe ndihmë financiare edhe trajnimi për kultivimin e mjedrave. Bujqit e përzgjedhur të cilët do të vazhdojnë të marrin mbështetje të mëtejme nga trajnerët me përvojë të projektit APR dhe të Hit Flores, kanë krijuar kopshtet e mjedrave në një sipërfaqe prej 0.1 hektar secili. Të gjitha palët kanë kontribuar në shpenzimet e përgjithshme: projekti APR ka kontribuar me një vlerë prej 5,900 € (26% e shpenzimit të përgjithshëm); bujqit (36%) me blerjen e sistemit mbështetës dhe të ujitjes, dhe Hit Flores me 38% të shpenzimit të përgjithshëm në mënyrë që të furnizojnë secilin bujk me 850 fidane. Hit Flores do të vazhdojë të sigurojë mbështetje teknike në rritjen dhe mbledhjen përfundimtare të prodhimeve.

Rezultatet e bashkëpunimit

Nga ky investim, pritet që secili bujk të krijojë të ardhura vjetore prej së paku 3,000 € duke i'a shitur mjedrat kompanisë Hit Flores.

Pos 20 bujqve, nga projekti do të përfitojnë përafërsisht edhe 74 femra dhe 70 meshkuj – familjarë të përfituesve të drejtëpërdrejtë, përmes rritjes së të ardhurave familjare dhe punësimit shtesë në kohën e mbledhjes përfundimtare të prodhimit. Si rezultat I këtij bashkëpunimi, bujq të tjerë kanë shprehur interesim që poashtu të kultivojnë prodhime për të furnizuar kompaninë Hit Flores dhe përpunuesit tjerë, dhe kështu grupe të tjera të bujqve do të mbështeten në vitin 2014.

Studim Rasti: Blegtoria dhe Prodhimet e qumështit – Një traditë ekzistuese u rizgjua

Pasqyrë e përgjithshme

Puna me prodhimtarinë e prodhimeve të qumështit është pjesë e një tradite bujqësore të gjatë dhe për mburrje në Kosovë. Kushtet e mira të rritjes dhe sipërfaqja e konsiderueshme e kullotave me rreth 178.000 hektarë në gjithë Kosovën ofron një mundësi të shkëlqyeshme për njerëzit në zonat rurale për të punuar në sektorin e prodhimeve të qumështit. Me migrimin e njerëzve nga zonat rurale në qendrat urbane, numri i bagëtisë është zvogëluar në mënyrë drastike. Kjo ka rezultuar me një rritje të importit të prodhimeve të qumështit dhe djathit dhe në humbje të ekspertizës në shumë fusha për përmirësimin e praktikave të prodhimit.

Ndryshimet e fundit në Kosovë kanë filluar t'a kthejnë këtë trend. Shoqata e përpunuesve të qumështit me sukses ka lobuar për më shumë mbështetje nga qeveria e Kosovës, si dhe për ndryshimet në ligjin e taksave i cili e bën më të lehtë për t'u marrë me bujqit e vegjël. Iniciativa e projektit APR për të organizuar trajnime për përpunimet e qumështit në Dragash, Shtrpce, Novobërdë dhe Kamenicë ka për qëllim të ndihmojë bujqit te përfitojnë nga këto mundësi te ripërtrira për qumështin vendor.

Ndërhyrja nga projekti APR

Pavarësisht zvogëlimit të prodhimit, në rajonet e synuara ekziston sistemi për grumbullimin e qumështit nga fermerët dhe bartja e tij deri te përpunuesit. Këto biznese lokale kanë qenë të gatshme të punojnë me projektin APR në mënyrë që të shtojnë cilësinë dhe sasinë e qumështit me të cilin furnizohen.

Janë organizuar takime me të gjithë akterët e zingjirit të vlerës për të identifikuar bujqit dhe temat e trajnimit me të cilat do t'i përkrahte projekti APR.

Projekti APR angazhoi ekspertë dhe trajnoi 180 bujq, prej të cilëve 12% ishin femra dhe 39% minoritete. Trajnimet janë mbajtur në 13 grupe me rreth 15 bujq. Temat e trajnimit kanë qenë të ndryshme, nga prodhimi dhe shëndeti i bagëtisë deri te higjiena dhe standardet e qumështit. Gjatë seancave të trajnimit, bujqve i'u ka dhënë mundësia të ushtrojnë punë praktike dhe teorike. Trajnimet kanë përmirësuar kapacitetet profesionale dhe teknike të bujqve në terren.

Rezultatet e bashkëpunimit

Duke parë numrin e përfituesve, interesimin e treguar për këtë lëmi dhe rezultatet fillestare premtuese, projekti APR pret rezultate të konsiderueshme nga ky përkushtim. 20% të përfituesve janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm për inpute, pajisje për mjelje dhe makineri të fermës. 30% e përfituesve kanë shtuar numrin e bagëtisë dhe kanë rritur numrin e punëtorëve në fermat e tyre. Për më tepër, qendrat e grumbullimit të qumështit kanë raportuar se cilësia dhe sasia e qumështit është rritur në masë të konsiderueshme, sidomos në sezonin dimëror, që tradicionalisht është një periudhë e prodhimit më të ulët të qumështit.